

RAPORTI

I

VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

TE AKTIVITETIT:

“UZINE EKZISTUESE E FERRO – KROMIT, BURREL”

Subjekti: “Albchrome” sh.p.k

Vendndodhja: Burrel, Qarku Diber

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2015



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

4. **MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Uzine ekzistuese e ferro – kromit, Burrel”

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legjislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

“Uzine ekzistuese e ferro – kromit, Burrel “

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti "Albchrome" sh.p.k është rregjistruar pranë QKR-se me datë 13/04/2001 , me numer NIPT-ti K11613001M . Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në **Burrel, Qarku Diber.**

1.1. Vendndodhja e projektit

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në **Burrel, Qarku Diber.**

1.2 Përshkrimi i aktivitetit

Projekti që kërkohej të zbatohet nga subjekti "Albchrome" sh.p.k. parashikon funksionimin e fabrikës për pasurimin e mineralit të kromit si dhe venddepozitimin (Dampen) e mbetjeve teknologjike ose të ashtuquajtura "mbetje sterile".

Fabrika e pasurimit ndodhet në zonën administrative të bashkisë Burrel, Qarku Diber. Koncentrati i kromit është produkt i kërkuar në eksport por edhe për shkrirje në uzinat e ferrokromit. Prodhimi i koncentratit të kromit nga pasurimi i mineralit të kromit të varfer me përmbajtje nga 10 deri 28 % Cr_2O_3 , aktualisht dhe në të ardhmen do të nxitet nga pakesimi i prodhimit të mineralit të pasur të kromit, për arsye se rezervat ekzistuese të mineralit të pasur ndodhen në thellësira me të mëdha. Projekti është në mbështetje të strategjisë kombëtare të zhvillimit të industrisë nxjerrëse e përpunuese të mineralit të kromit. Rezervat e mineralit të kromit të varfer në minierat e Ternovës e përreth tyre janë të konsiderueshme. Kapaciteti përpunues i fabrikës së pasurimit të kromit është parashikuar 70 mijë ton në vit, me përmbajtje mesatare 18 - 22 % Cr_2O_3 .

Perberja mineralogjike e mineralit të kromit që do të përpunohet në fabrikën e pasurimit siguron tregues tekniko - ekonomike dhe mjedisor (shkarkimet) optimale. Nga ana e konstruksionit ndërtimor fabrika është lehtësisht e zmontueshme, për tu vendosur diku tjetër natyrisht në funksion të kohës së punës etj. Funksionimi i fabrikës së pasurimit ndikon pozitivisht edhe në zbutjen e papunsisë në këtë zonë.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

- Klima

Territori ne te cilen ndodhet zona e liqenit te Bardhe, si ne te gjithe krahinen e rrethit te Bulqizes, perfaqesohet nga nje klime kontinentale, me dimer te gjate e te ftohte dhe vere te shkurter e te nxehte. Periudha e dimrit shoqerohet me reshje shiu dhe debore. Ngrica zakonisht fillon ne fund te muajit Tetor dhe shpesh zgjat deri ne fund te muajit Mars. Reshjet e debores zakonisht kalojne trashesine 1 meter. Muaji Janar dhe Shkurt vleresohen si muajt me te ftohte te vitit, ku jane regjistruar temperatura deri - 25 e - 30°C. Ne kete periudhe jane te shpeshta edhe bllokimet e rrugeve automobilistike nga ngrica dhe Debora.

Periudha 15 Qeshor- 30 Gusht, vleresohet si periudha me e thate e vitit, me sasi te vogla shiu dhe shume e nxehte. Temperatura maksimale te regjistruara ne kete periudhe, sidomos gjate vitit 2007 kane kaluar +35°C. Zona eshte pothuajse gjithmone nen ndikimin e ereave qe fryjne ne drejtime te ndryshme, sidomos Veri Lindje-Jug Perendim.

- Flora dhe fauna

Zona ne te cilen eshte objekti paraqet nje peisazh te zakonshem, me nje relief te thyer malor, te zhveshur e nuk gezon ndonje status mbrojtje te vecante ne lidhje me floren e faunen. Bimesia e zones ku eshte objekti ka natyre me ndonje prani shkurre te larta , njekohesisht me larg objektit ka dhe pishe, ah etj. karakteristike te zonave te tilla, ne vartesi te struktures se tokes e kushteve klimaterike. Theksojme se ne keto vite tranzicioni kjo zone ka shpyllezuar thujse mbi 70 % masivet pyjore gje e cila duket qarte ne mjediset perreth edhe ketij teritori ku do te zhvillohet kjo veprimtari. Ne zonen afer nuk ka kullota malore, por ato jane larg teritorit qe mendohet per shfrytezim. Fauna eshte e pasur me specie te ndryshme nga ujku, dhelpra., lepuri etj, krahas zvarranikeve, zogjve e brejtes te tjere.

- Toka, kategoria e saj, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.

Siperfaqja e tokes te kerkuar per shfrytezim nga subjekti i siperpermendur, eshte percaktuar qarte ne projektin teknologjik, e referuar struktures se saj deri tani nuk ka patur interes perdorimi per ndonje aktiviteti tjeter. Njekohesisht theksojme se kjo siperfaqe eshte toke madje deri ne inproduktive per disa kultura bujqesore etj, per shkak te lartesis se madhe mbi nivelin e detit te

ketij objekti. Nga pikpamja gjeologjike siperfaqja e perdorur per kete aktivitet eshte i perberjes ultrabazike e ne keto rrethana, aktualisht nuk paraqet interes per shfrytezim pasurie tjeter pervec kromit dhe shoqeruesve te tij. Vendi ku do te aplikohet projekti nuk perben terren rreshqites, sepse eshte kryesisht masiv shkembor, prandaj nuk parashikohet ndonje ndikim negativ per popullaten.

- **Hidrologjia e rajonit ku ndodhet objekti.**

Nga kjo veprimtari nuk ka ndikim ne ujrat nentokesore, njekohesisht projekti nuk parashikon ndonje shpim nentokesor per qellim perdorimi te tyre. Ne terrenin siper sheshit te objektit jane perroska te cilat ne raste rreshjesh grumbullojne sasira uji duke kaluar me tej ne perrenjte e tjere te zones Ne afersi te objektit nuk ka sistem drenazhimi apo rrjet kanalizimi per nevoja te populates.

- **Faktoret klimatike, cilesia e ajrit etj.**

Sipas Rajonizimit Klimatik te Shqiperise sheshi i fabrikes perfshihet ne Zonen Mesdhetare Malore, ne n/zonen lindore te saj, e cila perfshin malet ne jug te lugines se Drinit dhe ne veri te lugines se Shkumbinit. Kjo nlzone ka klime te ashper dhe temperatura mesatare vjetore ,per pjesen e ulet 1100 - 1500 m mbi nivelin e detit, *ne te cilen perfshihet edhe sheshi i fabrikes qe* lekunden ne kufijte 7 – 10 °C, ndersa ne pjesen me te larte 2- 6 °C. Minimumet absolute luhaten nga - 10 ° deri ne - 15 °C dhe ne dimra me te ftohte ulen deri ne -18 e -20 ° C, ne raste te rralla e ne dite te vecanta arrijne deri ne - 30 ° C. Ditet e akullta ne pjesen e ulet jane 120 - 150 dite ne vit, ne pjesen e larte 180 - 220 dite. Temperatura mesatre e Janarit lekundet ne intervalin 2 - 3 °C per pjesen e ulet, dhe per pjesen me te larte ne pikat me te larta - 8 deri - 10°C.

- **Trashegimia arkitektonike dhe historike.**

Lidhja e objektit me rruget ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit te shfrytezimit te kesaj fabrike eshte larg zonave te mbrojtura me status te vecante.

- **Peisazhi dhe topografia**

Vendi i pergatitjes, ndertimit dhe shfrytezimit te objektit eshte mjaft larg zonave te banuara. Sipas projektit parashikohet nje pershtatje e tij me peisazhin perreth, krahas masave per reabilitim gjate punes dhe pas ndalimit te aktivitetit. Ne zonen e ketij aktiviteti nuk kemi te kultivuar bimesi te dendur, por subjekti do te permiresoje peisazhin perreth duke zbatuar nje projekt reabilitimi me mbjelljen e disa fidaneve pyjore qe jane te pershtatshme me strukturen e tokes dhe klimen .

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te fabrikes te riciklimit te plastikes dhe prodhimit te ambalazheve plastike. Aktiviteti eshte me karakter riciklues dhe teknologjia qe ai do te perdore garanton ndikime minimale ne mjedis.

- **Ndryshimet ne popullsi**

Aktiviteti i firmes "Albchrome" sh.p.k ne pasurimin e mineralit te kromit, eshte shume i vogel ne krahasim me popullsinë e rajonit, pasi dhe vete popullsia qe banon ne zonen ku synohet te zhvillohet projekti eshte shume e vogel dhe ne distance te larget nga fabrika. Por duke e pare ne kontekstet e fabrikes se pasurimit te mineralit te kromit mund te themi se aktiviteti ne fjale do te ketë ndikim pozitiv ne popullsinë e zonës, duke kontribuar drejtpërsëdrejti ne rritjen e mirëqënies së tyre ne permissimin e infrastrukturës së zonës dhe punësimin e tyre.

- **Nivelet dhe ndikimet e emetimeve të ardhura nga projekti i zhvillimit gjatë fazës normale të operimit**

Gjatë fazës normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazrave, lëngjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, duke përfshirë të gjitha llojet e bimëve dhe gjallesave të ndryshme. Gjatë transportit të mineralit te kromit do të

punojnë makinat e transportit, por që nuk kanë ndonjë ndikim në mjedis pasi qëndrimi i tyre në objekt nuk do të jetë për një kohë të gjatë. Mjetet e transportit nuk do të krijojnë ndonjë problem në trafikun e mjeteve pasi dhe numri i tyre do të jetë i vogël.

- **Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga projekti zhvillues**

Zhurma në këtë objekt do të shkaktohen vetëm nga procesi i bluarjes dhe thyerjes së mineralit të kromit, punonjesit do të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse për veshet. Zhurmat e tjera do të jenë nga mjetet e ngarkimit dhe atyre të transportit. Zhurmë tjetër do të jetë ajo e mjeteve të transportit, të cilat numri i tyre do të jetë shumë i vogël dhe zhurmat janë të papërfillshme dhe të kontrolluara.

- **Emetimet në ajër**

Emetimet në ajër përfaqësohen nga gazrat që dalin nga motorët e makinave të transportit gjatë transportimit të mineralit të kromit. Duke marrë edhe parasysh që qendrat e banuara janë në një distancë relativisht të largët nga zona ku do të ushtrohet aktiviteti për pasurimin e mineralit të kromit dhe ku do të punojnë këto makina. Emetimet e tjera në ajër përfaqësohen vetëm nga gazrat e materialeve me djegje të brendshme të kompresorit të makinave të ngarkimit dhe të mjeteve të transportit që do të përdoren në fabrike. Gjithashtu një tjetër ndikim vjen dhe nga emetimet e grimcave të pluhurit si pasojë e thyerjes dhe bluarjes së mineralit të kromit.

- **Flora dhe fauna**

Në zonën ku është instaluar linja teknologjike e Fabrikës së Pasurimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me status të veçantë. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket nga aktiviteti i fabrikës, mbasi sipërfaqja e objektit është pothuajse e zhveshur nga bimesia.

- **Trajtimi i ujrave**

Teknologjia për pasurimin e mineralit të kromit parashikon përdorimin e ujit për realizimin e proceseve kryesore që zhvillon në fabrike. Ujrat e teknologjike do të trajtohen me metoda fiziko-kimike dhe do të dekantohen duke ruajtur cilësinë e mjedisit ujor për të. Rrjedhja e metejshme e

tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre. Ujrat e perdorura do te riperdoren perseri ne procesin per pasurimin e mineralit te kromit.

- **Prodhimi i mbetjeve dhe depozitimi i materialve qe krijohet gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit**

Gjate proceseve qe zhvillohen ne Fabriken e Pasurimit te mineralit te kromit, kemi gjenerimin e nje sasive mbetjesh sterile, te cilat depozitohen ne vendepozitimin e caktuar nga shoqeria per ruajtjen e metejshme te tyre ne kushte strike, duke mos ndikuar ne cilesine e mjedisit te zones perreth.

- **Ndikimi ne infrastrukturen e zones se objektit**

Fabrika gjate fazes se funksionimit te saj eshte e lidhur me rrugen ekzistues te pershkruar ne projekt. Transporti i materialit nga objekti e perpunimit do te behet me kamione 30 ton duke perdorur rrugen e permendur me siper . Aktiviteti i transporti qe do te kryhet nga subjekti i shfrytezimit deri ne Fabriken e pasurimit nuk e rendon trafikun aktual ne rruge, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do te sigurohet marrja e masave si me poshte:

- **Cilesia e ajrit**

Per permiresimin e cilesise se ajrit ne ambientet e punes subjekti “Albchrome” do te investoje per mbrojtjen e mjedisit per ndikimet negative. Ne linjen e thyerjes dhe bluarjes se kromit do te instalohen sfrucatore te cilet bejne kapjen e pluhurit. Punetoret do te pajisenme maska me fibra karboni. Per eliminimin e grimcave te pluhurit qe mund te krijohet gjate ngarkimit-shkarkimit dhe transportit te lendes se pare, investitori ka ndertuar nje rrjete te brendshem per sperkatjen e sheshit me uje, kryesisht gjate periudhes Qershor-Shtator ku dhe temperaturat jane me te larta dhe mundesia e perhapjes se pluhurit eshte me e madhe.

- **Zhurmat**

Per eliminimin e zhurmave shoqeria ka investuar ne nje sere masash e paisjesh. Punonjesit jane te paisur me tapa veshesh per te shmangur nivelin e larte te zhurmave ne organet shqisore dhe jane te paisur me veshje te tille per tu mbrojtur njekohesisht edhe nga pluhurat demtimet e syve, vesheve, etj. Nepermjet maskave te posatshme.

- **Rastet aksidentale**

Do merren masat per parandalimin e tyre, pajisjet ne fabrike do kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata do jene te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria do i pajis me uniforma dhe mjete mbrojtese.

- **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar do te varet nga respektimi i te gjithte treguesve te percaktuar. Kontrolli dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes ne shoqeri do te çojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerezve dhe mjedisin perreth. Nuk ka shkurre te gjata perreth.

KONKLUZIONE

- ✓ Zbatimi i projektit do te kontribuojë ne rritjen ekonomike ne nivel lokal dhe kombetar si dhe rritjen e mundesive per vende te reja pune.
- ✓ Zbatimi me korrektesi i teknologjise lejon qe shkarkimet ne atmosfere te mbeten brenda normave te percaktuara per kete lloj industrie
- ✓ Procesi teknologjik nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Gjate procesit te punes do kemi perdorim masiv te ujit vetem per te ftohur makinerite, nuk ka perdorim tjetër te tij. Kjo sasi uji riperdoret disa here dhe nuk permban elemente kontaminues ne perberjen e tij.
- ✓ Niveli i zhurmave në fabrike eshte ne parametra normal dhe ne nivele të pranueshme sepse pajisjet qe punojne duke llogaritur siperfaqen e hapur nuk kryejne ndotje akustike.
- ✓ Per nje pune sa me optimale në fabrike zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punonjesit njihen me keto rregulla ne menyre periodike.

REKOMANDIME

- Te merren masa dhe te kryhet reabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te pajisjeve dhe mjeteve te transportit.
- Te kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluese ne territor.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
- Te largohen te gjitha mbetjet ngurta qe krijohen si rezultat i aktivitetit njerezor ne vendet e percaktuara nga pushteti lokal.

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI